

# buletiniinfo

Buletin informativ mjuor  
Shtator, 2022



Mësuesve u kemi besuar  
një profesion të shenjtë



Monitorohet implementimi  
i projekteve nëpër komuna



Robert Walser  
1878-1956

## PËRÇARJET NUK NA SJELLIN ASNJË TË MIRË

**S**a herë që ndodhin emergjena, nga zjarri apo nga uji, përgjigja institucionale është shumë e ngadaltë në ofrimin e ndihmës për këto raste. Kosova, për këto dy dekada, nuk ka ndërtuar mekanizma adekuat për intervenime emergjente. Për derisa nuk sigurohen objektet e banimit nga kompanitë e sigurimit, institucionet e vendit duhet të ndajnë fonde të veçanta për këto raste emergjente.

Vërshimet nga reshjet e rrëmbyeshme të shiut, gjatë këtij muaji, i dëmtuan më së shumti familjet e komunitetit Egjiptian në Gjakovë, në lagjen "Shotë Galica" në Brekoc. Mjafton që të mos ndalet shiu gjatë natës dhe këto familje të kërcënohen nga ujërat e rrëmbyeshëm. Vërshimi i shpeshtë i shtëpive nga ujërat e rrëmbyeshëm reflekton edhe gjendjen e të jetuarit e një pjese të komunitetit. Prandaj të jesh përfaqësues i komunitetit që rrezikon të vërshohët sa herë që bije shi, është punë shumë më e vështirë se sa të jesh përfaqësues i shumicës.

Në Qeverinë e Kosovës e kemi, për herë të parë, një Ministër nga komuniteti Egjiptian. Ai është caktuar Ministër për të qeverisur me Ministrinë e Pushtetit Lokal, me 38 komuna të Kosovës. Ministri ka përgjegjësi të mëdha në mbikëqyrjen e ligjshmërisë së vendimeve te të gjitha komunave të Kosovës, me zhvillimin e politikave që avancojnë shërbimet komunale dhe përballje e përditshme me problemet e pushtetit lokal. Për herë të parë në këtë Ministri, projektet që bashke financohen nga Ministria, donatorët dhe Komunat, kanë përfshirë projekte me fokus komunitetet. Asnjë herë kjo nuk ka ndodh në Qeveritë e

mëparshme. Projektet financohen nga Ministria por implementohen nga Komunat. Në vitin e kaluar, shumica e projekteve janë realizuar. Por pasi që kishim zgjedhjet lokale, disa nga këto projekte nuk janë realizuar dhe disa nuk janë finalizuar tërësisht. Kjo është përgjegjësi e komunave. Edhe në këtë vit janë nënshkruar marrëveshje me komunën e Lipjanit, Rahovecit, Istogut, Klinës, Pejës, Obiliqit, Shtimës për projekte në vlerë rreth 1 milion euro që përmirësojnë infrastrukturën e banorëve të komunitetit Egjiptian e Ashkali. Asnjë projekt kapital nuk është financuar nga Qeveritë e kaluara kur kemi pas nga 2 zëvendës ministra.

Sot, nëse je pozicionuar kundër Qeverisë, je i mirëseardhur në shumicën e mediumeve të Kosovës. Edhe nëse je një ish deputet, që sot nuk qon kurrfarë peshe, ke hapësirë të mjaftueshme në emisione, vetëm për të bërë një titull për klikime.

Prandaj përpjekjet për të dezinformuar opinionin lidhur me punën e ministrit Elbert Krasniqi nga ish përfaqësuesit e komunitetit tonë, janë shpërthime emocionale nga praktikat e bazuara në të bërit politikë me inat.

Komuniteti Egjiptian i Kosovës nuk duhet të udhëhiqet nga politika e inateve, që është instaluar në vitin 2014. Duhet injorohen të gjithë ata politikan që nxisin urrejtje e ndarje përmes shkrimeve në facebook e studio televizive, sepse përçarjet nuk i sjellin asnjë të mirë popullit. Ka shumë probleme me varfërinë, pabarazinë, identitetin etnik, prandaj inati duhet të zëvendësohet me urtësi.

Fazli Stollaj



## REAGIMI I DEPUTETIT FRIDON LALA LIDHUR ME NJË VIDEO NË RRJETAT SOCIALE KU SULMOHET VERBALISHT NJË E MITUR

Me datën 19.09.2022, KIKS Kosova ka shpërndarë në rrjetin Facebook një video të shoqëruar me një tekstu me titull "Skandal në Qendër të Prishtinës".

"Një qytetar, i cili në të njëjtën kohë xhiron me telefonin e tij, i drejtohet një fëmije, vajzë e vogël nga komuniteti rom, me fjalë të rënda.

Në një video të publikuar në TikTok, ai i drejtohet vajzës me fjalët "Hajde të q... të prishi. Hape gojën."

Vajza nuk arrin të kuptojë fjalët, me të cilat i drejtohet dhe afrohet drejt tij."

Kjo video ka ngjallë reagime të mëdha duke bërë komente dhe shpërndarje në rrjetin social facebook.

Deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e IRDK-së, në llogarinë e tij në facebook, ka bërë këtë reagim:

"Fatkeqësisht, ky është niveli që kanë arritë monstrumët pedofilë në shoqërinë tonë.

Dështimi i sistemit të drejtësisë, që ndër vite të dënoj kriminelët, abuzuesit e dhunuesit ka krijuar hapësirë për zhvillimin e monstrumëve si lloji i këtij në video.

Kur sistemi na lë në frikë për vajzat e fëmijët tanë, ngase lloji i këtij në video qarkullojnë të lirë, qytetaria aktive është e domosdoshme në demaskimin e monstrumëve dhe kushdo qe ka informacione duhet ti raportoj vazhdimisht dhe së bashku të kërkojmë parreshtur dënimin meritor të tyre."



## NGA VËRSHIMET NË GJAKOVË PËSON MË SË SHUMTI KOMUNITETI EGJIPTIAN

Reshjet e shumta të shiut, me datën 16 dhe 17 Shtator të këtij viti, shkaktuan dëme si pasojë e vërshimeve në disa Komuna të Kosovës. Komunat më të prekura nga këto vërshime ishin komuna e Gjakovës dhe komuna e Rahovecit, ndërsa lagja "Shotë Galica" në Berkoc komuna e Gjakovës, e banuar nga komuniteti Egjiptian ka pësuar më së shumti. Në këtë lagje, për shkak të pozitës në të cilën ndodhet, uji i rrëmbyeshëm ka depërtuar nepër shtëpi e banorëve të kësaj lagje duke shkaktuar dëme të konsiderueshme.

Për të qenë bashkë me banoret e Gjakovës dhe Rahovecit, Ministri i MAPL-së, Elbert Krasniqi, i shoqëruar me deputetin e IRDK-së Fridon Lala, me datën 19 shatator gjatë terë ditës kanë qëndruar në lokacionet e rrezikuara nga këto vërshime në komunën e Gjakovës dhe komunës së Rahovecit.

Në orët e para të 17 shtatorit, ministri Elbert Krasniqi, bashkë me deputetin Fridon Lala dhe kryetarin e komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi, kanë vizituat fshatin Bellacërkë, Ratkoc dhe Radoste, për të parë nga afër gjendjen nga vërshimet në këto lokalitete.

Ministri Elbert Krasniqi dhe Deputeti Fridon Lala, bashkë me Ministrin e Punëve të Brendshme z. Xhelal Sveçla dhe Kryetarin e Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini vizituam lokalitetet e prekura nga vërshimet në komunën e Gjakovës.



Nga vizita e Ministrave Elbert Krasniq, Xhelal Sveçla dhe deputeti I IRDK-së Fridon Lala në lagjën  
Shotë Galica në Brekoc, komuna e Gjakovës



Përfaqësuesit e IRDK-së në Gjakovë në aksion për ti ndihmuar me ushqime të rrezikuarit nga përmbytjet në lagjën Shotë Galica në Brekoc të Gjakovës

Në Lagjen Berkoc, kanë vizituar disa nga familjet të cilat janë dëmtuar. Ata kanë ofruar mbështetje institucionale për qëndrim të përkohshëm dhe mbështetjen e nevojshme për këto familje. Deputeti Fridon Lala, lidhur me vërshimet në Brekoc, ka thë se është siguruar strehimi i përkohshëm, furnizim me ushqim dhe pijë, sigurimi i mbështetjes financiare nga qeveria për mbështetje emergjente, pagesë e qirasë nga Komuna e Gjakovës dhe plan për banim social afatgjatë dhe largim nga zona e rrezikuar përmes bashkëpunimit ndër-institucional.



Ministri Elbert Krasniq, deputeti Fridon Lala dhe kryetari i komunës së Rahovecit vizitojnë vendet e përfshira nga vërshimet në komunën e Rahovecit



## DEPUTETI I IRDK-SË, FRIDON LALA, NË VIZITË PUNE NË PARLAMENTIN EUROPIAN NË BRUKSEL

Deputeti i IRDK-së, Fridon Lala, i cili është edhe nënkyetar i Komisionit për Integrim European, është pjesë e delegacionit të Kuvendit të Kosovës i cili po qëndron për vizitë në Parlamentin European në Bruksel.

Gjatë javës, delegacioni ka takuar euro-deputetë të ndryshëm, nënkyrytarin e Parlamentit European Rainer Wieland, raportuesen e Parlamentit European për Kosovë Viola von Cramon, dhe udhëheqës të grupeve të ndryshme politike brenda Parlamentit European.

Ndër tjerash, deputeti Lala ka përmendur shembullin e mirë të diversitetit etnik dhe marrëdhënieve të mira ndër-etnike që pasqyron Kosova. Po ashtu, ai ri-konfirmoi mbështetjen, përkrahjen dhe angazhimin e përfaqësuesve të komunitetit egjiptian krahas spektrit politik kosovar për të gjitha proceset e integrimit euro-atlantik të Kosovës.





## MINISTRI ELBERT KRASNIQI VIZITON KOMUNAT NË TË CILAT PRITET REALZIMI I PROJEKTEVE

Në kuadër të bashkëfinancimit të projekteve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me Komunat e Kosovës, Ministri i MAPL-së ka nënshkuar marrëveshjet e bashkëpunimit me 20 komuna të Kosovës për realizimin e projekteve kapitale me fokus komunitetet. Në vlerë prej 1 milion euro.

Sipas marrëveshjeve të nënshkuara, komunat respektive do të zhvillojnë procedurat e prokurimit publik ku do të përzgjedhjen operatorët ekonomik për ekzekutimin e punimeve sipas planifikimit që kanë bërë komunat.

Për të pa progresin e implementimit të projekteve, këto ditë, ministri Elbert Krasniq është duke i vizituar komunat ku pritet të realizohen projektet. Ai bashkë me kryetarët e komunave kanë dalë në terren dhe kanë përcjellë punimet e realizuara deri me tani. Realizimi i projekteve është i rëndësishëm përfaktin se tani jemi duke hyrë në tremujorin e fundit të këtij viti dhe realizimi i projekteve duhet të implementohet në harmoni me dinamikën kohore deri në gjysmën e dytë të muajit dhjetor.



Me datën 20.09.2022, Ministri i MAPL-së Elbert Krasniqi, e ka vizituar komunën e Lipjanit.

Ministri është pritur nga kryetari i komunës së Pejës, Imri Ahmeti, me të cilin kanë diskutuar lidhur me ecurinë e realizimit të projekteve komunale, bashkëpunimin në mes të Komunës dhe Qeverisë si dhe për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve komunale për qytetarët.

Gjatë kësaj vizite, bashkë me kryetarin Imri Ahmeti,

Nënkyetarin Lulzim Arifi dhe zyrtar tjerë komunal janë vizituar lokacionet në të cilat po realizohen projektet e finançuara nga MAPL, siç janë: asfaltimi i rrugëve në Lipjan dhe Hallaq i Vogël, projekti për rregullimin e hapësirave publike dhe rregullimi i shtratit të Lumit Janjevka në lagjen e Konjuhit në Lipjan.



Me datën 21.09.2022, ministri i MAPL-së Elbert Krasniqi, e ka vizituar komunën e Pejës. Ministri është pritur nga kryetari i komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, me të cili është diskutuar për procesin e projekteve komunale, projektet ndërkufitare dhe priorititetet e Komunës për të ofruar shërbime komunale më efikase për qytetarët.

Në kuadër të realizimit të projekteve të finançuara nga

MAPL për komunën e Pejës, Ministri Elbert Krasniqi ka vizituar shkollën teknike 'Shaban Spahija' i cili është një nga projektet e finançuara nga Granti i Performancës Komunale dhe projektet në lagjen 7 Shtatori për rregullimin e infrastrukturës te lagjet e banuara nga komunitetet, të finançuara nga programi komunal për infrastrukturë socio-ekonomike.



Me datën 23.09.2022, ministri i MAPL-së Elbert Krasniqi, e ka vizituar komunën e Klinës. Ministri është pritur nga kryetari i komunës së Klinës, Zenun Elezaj, me të cilin kanë bashkëbiseduar lidhur me prioritetet e Komunës, bashkëpunimin në mes Qeverisë dhe Komunës dhe procesin e mbarëvajtjes së projekteve komunale.

I shoqëruar nga Kryetari Zenun Elezaj, ministri Elbert Krasniqi ka vizituar lokacionet ku janë duke u realizuar projektet e finançuara nga MAPL.

Ata vizituan projektet:

Rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse nga Qyteti i Klinës deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë, të finançuara nga instrumenti për investime kapitale;

Asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Vidëjë-Jagodë, Paskalicë dhe Kryeshevë të Madhe si dhe projektin për pastrimin dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve të finançuara nga programi për projekte infrastrukturore me bazë në komunitete.





Me datën 27.09.2022, Ministri i MAPL-së Elbert Krasniqi, e ka vizituar komunën e Shtimes.

Ministri është pritur nga Kryetari i Komunës, Qemajl Aliu, ku kanë diskutuar për zhvillimin ekonomik lokal, bashkëpunimin në mes Qeverisë dhe Komunës si dhe mbarëvajtjen e proceseve të projekteve komunale.

Me Kryetarin Aliu, së bashku me banorët e fshatit përruruan projektin - rregullimi i parkut dhe këndit të lodrave në lagjen e komuniteteve në fshatin Gjyrkoc, financuar nga programi për mbështetje për projekte infrastrukturore për komunitete.

Gjithashtu, ata kanë vizituar biznesin e familjes Maliqi të cilët përmes përpunimit të metalit kanë arritur të jenë biznes i suksesshëm dhe i ndershëm në Komunën e Shtimës.





## MËSUESVE U KEMI BESUAR NJË PROFESSION TË SHENJTË, ATË TË EDUKIMIT TË BREZAVE TË ARDHSHËM

*Fjala e deputetit të IRDK-së, Fridon Lala, në Parlamentin e Kosovës, në deklarimet jashtë rendit të ditës, me datën 19 Maj 2022.*

Faleminderit, e nderuar kryesuese! I nderuar Kabinet qeveritar, Të nderuar kolegë deputetë, Shumë të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës, Në diskutimin tim të parë parlamentar si deputet i Republikës së Kosovës, në prezantimin e programit qeverisës, ndër të tjera kam kërkuar që në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të komuniteteve Qeveria të ketë angazhim maksimal në adresimin institucional të diskriminimit dhe racizmit, po më së pari funksionalizimit dhe pastaj fuqizimit të mekanizmave përkatës, të cilët do të krijonin infrastrukturën e nevojshme për parandalimin dhe trajtimin e drejtë dhe

efektiv të këtyre fenomeneve negative, të cilat përfat të keq akoma po na përcjellin në shumë raste.

Dy ditë më parë, përmes disa pamjeve të shëmtuara televizive na u dëshmua për të satën herë që diskriminimi e racizmi janë pjesë e përditshmërisë sonë shoqërore. Fëmijë, egjiptianë e ashkali ishin ndarë veçmas për të manifestuar festën e tyre të abetares në një organizim në Komunën e Pejës. Ato pamje janë plagë e rëndë për shoqërinë tonë multietnike të ndërtuar me shumë sakrifica e mund, mbi fundamentet e demokracisë moderne dhe do të ngelen gjatë në mendjet tona.



Shkolla është institucioni më i shenjtë për fëmijët dhe prishja e këtij imazhi do të shkatërronte ëndrrat e gjeneratave të shumta të ardhshme. Të lejojmë mbjelljen e urrejtjes te fëmijët është krimi më i madh që ne mund të bëjmë si shoqëri. Kosova që duam dhe për të cilën po punojmë nuk ka hapësirë për mësimdhënës që mbjellin urrejtje në mes nesh. Mësuesve u kemi besuar një profesion të shenjtë, atë të edukimit të brezave të ardhshëm dhe figura perfekte që fëmijët kanë për ta nuk guxon të shndërrohet në figurë të një mësuesi ordiner, i cili bën dallime mes tyre. Pamjet nga Peja tregojnë një realitet të hidhur se si këto komunitete akoma përjashtohen në mesin e shoqërisë sonë. Duhet ta kuptojmë njëherë e përgjithmonë që egjiptianët, si dhe ashkalintjtë dhe romët janë qytetarë të Republikës së Kosovës, atdheu i vetëm i tyre është Kosova, atdhe për të cilin ata kanë kontribuar me shekuj nga ndjenja e përkatësisë ndaj shtetit të Kosovës. Është obligim shtetëror yni që të ofrojmë të drejta dhe mundësi të barabarta për secilin qytetar dhe në këtë aspekt nuk tolerohet asnje kompromis apo preferencë selektive. Në kohë të vështira, komuniteti egjiptian ka dhënë mësues të shquar për vendin, andaj në asnje rrethanë nuk lejojmë përjashtimin e tyre nga sistemi arsimor sot. Prandaj, i bëj thirrje Ministrisë së Arsimit dhe kolegëve të mi

deputetë nga Komisioni për Edukim dhe Arsimit që të angazhohen intensivisht në arritjen e sistemit edukativo-arsimor gjithëpërfshirës, ngase fatkeqësisht në sistemin tonë arsimor akoma kemi mësues që bëjnë ndasi etnike, dallime klasore e linçime, përjashtime sociale e edhe i ulin fëmijët e komuniteteve në fund, duke i demotivuar totalisht ata fëmijë për të vijuar mësimet. Ata mësues e kanë vendin gjithkund tjeter pos në shkolla dhe të gjithë ne së bashku duhet të angazhohemi që ata t'i mbajmë sa më larg fëmijëve. Fëmijët e këtyre komuniteteve gjuhë amtare e kanë gjuhën shqipe dhe festa e abetares është është festë edhe e tyre dhe ata assesi nuk bën të ndahan nga fëmijët e tjerë për ta festuar këtë festë. Dhe, për fund, në emër timin dhe në emër të kolegëve Bekim Arifi dhe Erxhan Galushi po ashtu e përshëndesim përkrahjen e madhe që kemi marrë nga kolegët tanë deputetë dhe institucionë të ndryshme qeveritare për dënimin e këtij rasti, nga se kjo përkrahje masive tregon edhe 11 fenomenin e racizmit, i cili akoma është i pranishëm në shoqërinë tonë dhe të gjithë së bashku duhet të angazhohemi në mënyrë që sa më shpejt ta eliminojmë. Faleminderit!



## **ROBERT WALSER (1878-1956)**

### **FANTAZOJ**

Njerézit janë miqësorë atje. Ata ndjejnë nevojën e bukur për të pyetur njëri-tjetrin nëse duan të mbështesin njëri-tjetrin. Ata nuk kalojnë indiferentë me njëri-tjetrin, por as e shqetësojnë njëri-tjetrin. Ata janë të dashur, por nuk janë kuriozë. I afrohen njëri-tjetrit, por nuk e mundojnë njëri-tjetrin. Nëse je i pakënaqur atje, nuk ka shumë kohë dhe nëse ndihesh mirë atje, nuk ke besim të tepruar. Njerézit që banojnë aty ku banon mendimi janë larg nga kënaqësia në pakënaqësinë e dikujt tjetër dhe nga të ndjejnë gjësim të neveritshëm aty ku tjetri është i hutuar. Atyre u vjen turp për çdo gjësim keqdashës; ata preferojnë të dëmtohen vetë sesa të shohin dikë tjetër të dëmtuar. Këta njerëz kanë nevojë për bukuri për aq sa nuk u pëlqen t'i shohin njerézit e tjerë të dëmtuar. Të gjithë njerézit atje u dëshirojnë të gjithëve më të mirën. Askush nuk jeton atje që dëshiron vetëm të mirën për veten e tij dhe vetëm dëshiron të dijë se gruaja dhe fëmijët e tyre janë në duar të mira. Ai dëshiron që edhe gruaja dhe fëmijët e tjetrit të ndihen të lumtur. Nëse një njeri sheh ndonjë fatkeq atje, lumturia e tij tashmë është shkatërruar, sepse aty ku banon bamirësia, njerëzimi është një familje dhe askush nuk mund të jetë i lumtur atje nëse të gjithë nuk janë. Zilia dhe inati nuk dihen atje, dhe hakmarrja është e pamundur. Aty askush nuk i pengon tjetrit, askush nuk triumfon mbi tjetrin. Aty ku dikush shfaq dobësi, nuk ka njeri që i shfrytëzon menjëherë, sepse të gjithë janë shumë të vëmendshëm ndaj njëri-tjetrit. Të fortët dhe të fuqishmit nuk mund të fitojnë admirim atje, sepse të gjithë kanë forcë të ngjashme dhe kanë fuqi të barabartë. Njerézit japidh marrin në një alternim të këndshëm që nuk ofendon arsyen apo mirëkuptimin. Dashuria është ligji më i rëndësishëm atje; Miqësia është rregulli kryesor. Nuk ka gjë të tillë si të pasur dhe të varfër. Nuk ka pasur kurrë mbretër apo perandorë ku jetojnë njerëz të shëndetshëm. Atje gruaja nuk sundon mbi burrin, por as burri mbi gruan. Askush nuk sundon, por të gjithë mbi veten e tyre. Gjithçka i shërbën gjithçkaje atje dhe qëllimi i botës është qartë të largojë dhimbjen. Askush nuk dëshiron të kënaqet; rezultati është që të gjithë e bëjnë atë. Të gjithë duan të jenë të varfër; rrjedh se askush nuk është i varfër. Është bukur atje, dua të jetoj atje. Unë dua të jetoj mes njerëzve që ndihen të lirë sepse e kufizojnë veten. Unë dua të jetoj mes njerëzve që respektojnë njëri-tjetrin. Dua të jetoj mes njerëzve që nuk e njohin frikën. E shoh që jam duke fantazuar.

Përktheu: Artan Ferizaj

## VIZITË NË PLANQOR DHE SKIVJAN

Aida Morina, Këshilltare në Ministrinë e Shëndetësisë, me datën 22.09.2022, e shoqëruar nga Kryetari i degës së IRDK-së në Gjakovë, Skender Qorri, kanë dalë të vizitë në terren për të marrë informata më të hollësishme lidhur me gjendjen shëndëtësore të pjesëtarëve të komuniteteve Egjiptian, Ashkali e Rom. Gjatë kësaj vizite, ata vizituan fshatrat Planqor dhe Skivjan ku janë takuar me disa familje ku kanë bashkëbiseduar lidhur me gjendjen e tyre shëndëtësore. Ata kanë veçuar të bisedojnë në veçanti me nënrat e këtyre komuniteteve për problemet shëndëtësore me të cilat ato ballafaqohen.

Nga këto takime kanë konstatuar nevojën e realizimit të vizitave të ekipeve mjekësore mobile te këto familje, në veçanti te nënrat dhe fëmijët e tyre. Është shumë e nevojshme që nënrat e këtyre familjeve të informohen me shumë rreth shëndetit gjinekologjik dhe planifikimit familjar.

Aida Morina konsideron se prioritet i saj në angazhimet e saj do të jetë shëndeti i nënave dhe fëmijëve dhe për ketë do bëjë me përkushtim të madh.

Vizita të këtilla do i vazhdojmë në ditët në vijim edhe në lokalitete dhe komuna të tjera të Republikës së Kosovës.





## DREJTUESIT E DEGËS SË IRDK-SË VIZITOJNË DISA FAMILJE NË FSHATIN ZALLQ

Me datën 27.09.2022, kryetari i degës së IRDK-së në Istog, Lush Çukaj, bashkë me Nënkyryetarin e komunës së Istogut, Valmir Ramaj, ishim për vizitë në disa familje te fshatit Zallq. Qëllimi i kësaj vizite ishte vështrimi nga afër i gjendjes së ekonomive familjare. Ata vizituan familjen e Istref Ganaj dhe Mahir Ganaj dy familje të mëdha. Me gjithë gjendjen e rënduar ekonomike prioriteti i tyre për jetesë dhe mbajtje të familjes mbetët angazhimi i tyre me veprimitari nga bujqësia dhe blegtoria.

Në të njëjtën ditë, ata vizituan edhe Izet Kamberaj, nga i njëjti fshat, i cili është një bujk i dalluar i fshatit. Në këtë rast ata kanë vizituar fermën e tij e cila gjatë javës së fundit ka pësuar dëme të mëdha nga sulmet e ujqve ku i kanë mbytur një numër të konsiderueshëm të deleve.

Po ashtu janë vizituar edhe familjet që frekuentojnë rrugën "Sadri Lata", rrugë e cila është shumë e dëmtuar dhe kërkon ndërhyrje të menjëhershme. Kjo rrugë është përfshirë në projektin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe komunës së Istogut dhe pas përfundimit të procedurave administrative pritet që këtë vit kjo rrugë të asfaltohet dhe të jetë e kalueshme për banorët e kësaj ane.





## KRYETARI I DEGËS SË IRDK-së NË PEJË VIZITË NË VENDBANIME MË KOMUNITETE

Ma datën 28.09.2022, kryetari i degës së IRDK-së në Pejë ka vizituar banoret në disa lokacione në komunën e Pejës. Banorët e mirëpriten vizitën në këtë lokalitet, dhe në këtë rast ata i kanë shprehur brengat dhe problemet me të cilat po ballafaqohen. Në mesin e problemeve të banoreve të Qungurit ishte edhe defekti me furnizim me rrymë që kishte rezultuar me mungesë të energjisë elektrike për rreth një javë. Avdyl Berisha i cili është edhe Këshilltar i Ministrit të MAPL-së, Elbert Krasniqi, ka bashkëpunuar ngusht me Drejtorin e KEDS lidhur me këtë problem me është arritur që banorëve ti rikthehet furnizimi me energji elektrike. Gjatë kësaj vizite janë dëgjuar edhe probleme tjera të banoreve të kësaj ane për të cilat z. Avdyl Berisha është zotuar që të analizohen me kujdes me qëllim të zgjidhjes së tyre.



# *buletini* info

Kontriboni me shkrimet e juaja autentike si:

Opinione

Kulturë

Histori

Shkencë

Dërgoni në email: **buletini.info@gmail.com**